

20191081423

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR NDJEKJE TË KOMUNIKIMEVE

Neni 1

Në Ligjin për ndjekje të komunikimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 71/18), në nenin 4 në pikën 7) fjalët: "Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim" zëvendësohen me fjalët: "Agjencia për Siguri Nacionale".

Neni 2

Në nenin 20 në paragrafin (1) fjalët: "ministri i Punëve të Brendshme" zëvendësohen me fjalët: "drejtori i Agjencisë për Siguri Nacionale".

Neni 3

Në nenin 29 paragrafi (4) fjalët: "ministri i Punëve të Brendshme" zëvendësohen me fjalët: "drejtori i Agjencisë për Siguri Nacionale".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 shtatori 2019.